

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për veprimtarinë e vitit 2020 dhe duke mbajtur në konsideratë:

- angazhimin e KQZ-së në lidhje me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve; monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet;
- nxjerrjen e akteve nënligjore, pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, të kryera në tetor të vitit 2020,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020, në drejtim të:

Hartimit të programit të punës për vitet 2020 dhe 2021, me qëllim planifikimin e aktiviteteve që i paraprijnë organizimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 prill 2021.

Nxjerrjes së konkluzioneve dhe përditësimit të të dhënave për shtetasit që kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore ndër vite.

Miratimit të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator” nëpërmjet vendimit nr. 1, datë 26.10.2020.

Miratimit të rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 6.11.2020.

Kryerjes së procedurave për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së KQZ-së.

Përmbushjes së detyrimit ligjor për subjektet deklaruese të pasurisë për zyrtarët që janë larguar nga funksioni dhe zyrtarët që deklarojnë para fillimit të detyrës.

Procese të kryera për verifikimin e shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale, si dhe hedhjen e tyre në faqen zyrtare të KQZ-së.

Rishikimit të buxhetit të vitit 2020 nëpërmjet aktit normativ nr. 15, datë 15.4.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Miratimit të vendimeve në 6-mujorin e parë të vitit 2020, si dhe akteve nënligjore gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2020.

Shqyrtimit të rezultateve të verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Kryerjes së aktiviteteve në nivel lokal në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, mbështetje me ekspertizë të huaj, si dhe organizimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve të administratës së KQZ-së.

Procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.6.2019, me vendimin nr. 4, datë 21.2.2020 të KQZ-së.

Përgatitjes infrastrukture zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.4.2021.

Kuvendi kërkon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të miratohet Kodi Etik i institucionit në funksion edhe të përcaktimit të rregullave të përfaqësimit në publik të institucionit dhe të daljeve publike të anëtarëve të KQZ-së, në përputhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, të miratuar me vendim Kuvendi, brenda vitit 2021.

2. Të paraqesë pranë Kuvendit një raport të detajuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet e datës 25.4.2021 lidhur me shqyrtimet dhe zgjidhjet që u janë dhënë në rrugë administrative ankesave ndaj akteve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; shqyrtimet dhe zgjidhjet që u janë dhënë në rrugë administrative ankesave të subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ve; masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit

aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim; mbi sanksionet administrative të vendosura kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet; roli i KAS-it dhe Komisionit Rregullator në raport me çështjet e mësipërme deri te vendimet e dhëna nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor për këto çështje.

3. T'i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë raporti analitik për gjetjet dhe efektshmërinë e përdorimit të teknologjisë në tërësi, të përdorur ditën e zgjedhjeve, datë 25.4.2021, si dhe në ditët në vijim lidhur me procesin e votimit, numërimit elektronik, mbarëvajtjen e mbikëqyrjes së procesit të votimit dhe numërimit nëpërmjet sistemit të kamerave, identifikimit elektronik të qytetarëve, etj.

4. KQZ-ja të vijojë procedurat për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e procesit për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, si dhe nenit 20, shkronja “ç”, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, “Zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin.”.

5. KQZ-ja të paraqesë pranë Kuvendit raportin e auditimit të kryer për raportimin financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 për Kuvendin e Shqipërisë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021.